




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI



Drejtoria për Arsim
Nr.07/Zyrtarisht.
Deçan, dt.30.01.2019.

Në bazë të dispozitave të nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, si dhe konform nenit 2 pika 1 – 9 dhe nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr.08/2014 nga MASHT, Drejtorati për Arsim në Deçan, shpall :

KONKURS PUBLIK

Për zgjedhjen e drejtorit të institucionit të arsimit publik në komunën e Deçanit.

Institucioni : 1. SH.F.M.U. “ Lidhja e Prizrenit “- Deçan.

Drejtoria : Drejtoria për Arsim në Deçan

Titulli i vendit të punës : Drejtor shkolle

Kategoria funksionale/ Grada : 7.8:

Lloji i punës : Jo i karrieres (me kohë të caktuar – mandat)

KUSHTET : Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor në këtë shkollë duhet ti plotësojnë këto kushte :

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS 4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore..
3. Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedur të licencimit.
4. Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim .
5. Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucionet e arsimit.
6. **Të posedojnë këto dokumente :**
 - 6.1. Çertifikatën e lindjes.
 - 6.2. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës.
 - 6.3. Kopje e letërnjoftimit,
 - 6.4. Dëshminë për përvojën e punës.
 - 6.5. Portfolion profesionale
 - 6.6. Letër-referencë nga një institucion publik kredibil (si Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, DKA, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë).
 - 6.7. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punë dhe angazhimet paraprake.
 - 6.8. Planin zhvillimor të Institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 fronti i shkronjave 12 arial). sipas Udhëzimeve të MASHT.
 - 6.9. Çertifikatat e trajnimeve të zhvilluara.

6.10. Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore.

6.11. Dëshminë se nuk është nën hetime.

Marrëdhënia e punës krijohet përmes kontratës, në pajtim me nenin 8 pika 2 të Udhëzimit Administrativ nr.08/2014 dhe zgjatë 4 vjet.

Kandidatët e interesuar për konkurrim gëzojnë të drejtën e konkurrit në konkurs brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit 31.01.2019 e deri me dt.14.02.2019.

Aplikacionet për konkurrim merren dhe dorëzohen në zyrën pritëse të komunës së Deçanit.

DALEK-ELAZUA-DURBORIN
REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA VERODVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEČANE • DEČANSKI RAJONSKI ZAVOD

Mjesta-Dm: Dr. Asimiri Nr. Prot: 7989
Org. Jedin: 07 Dr. Prost: 3001/19
No. Papis: 07 Dato: 30.01.19

DEČAN DEČANE



Drejtori,

Mr. Sc. Bekim Vishaj